

MUHARREM DEZHGIU**DILEMAT E SIGURISË DHE ASPIRATA PERËNDIMORE
E SHQIPTARËVE NË GJYSMËN E PARË TË SHEK.XX**

Që nga krijimi i shtetit shqiptar, si rezultat i Shpalljes së Pavarësisë më 1912, shqiptarët i ka shoqëruar dilema e sigurisë dhe e prosperitetit të këtij shteti. Nëse i kërkojmë rrënjët e kësaj dileme të sigurisë, ato janë të natyrave të ndryshme: të karakterit politik, social, gjeopolitik të jashtëm e të brendshëm.

Njohja ndërkombëtare e Pavarësisë së Shqipërisë, më 23 korrik 1913, u përjetua në mënyrë kontradiktore në radhët e shqiptarëve, shpeshherë dhe brenda të njëjtit person. Nga njëra anë, ishte gëzimi për krijimin e shtetit të ëndërruar shqiptar dhe, nga ana tjetër, hidhërimi për copëtimin e trojeve dhe të popullsisë shqiptare. Pra, mosrealizimi i ëndrrës për krijimin e një shteti kombëtar shqiptar në trojet etnike.

Realizimi i krijimit dhe i njohjes ndërkombëtare të shtetit shqiptar, përcaktuan pyetjet themelore që lidhen me dilemën e sigurisë. Edhe mendimi politik shqiptar për këtë çështje u nda në dy drejtime të mëdha, i cili vazhdoi gjatë gjysmës së parë të shekullit të kaluar.

Para shqiptarëve dhe mendimit politik të tij, pas Shpalljes së Pavarësisë, shtrohej dilema: a duhej vazhduar veprimtaria politike, përfshirë dhe luftën e armatosur, për të përputhur kufijtë e shtetit me kufijtë e shtrirjes së kombit, apo duhej filluar puna për forcimin, zhvillimin dhe përparimin e shtetit të krijuar brenda kufijve të njohur ndërkombëtarisht? Dilema tjetër kishte të bënte me mundësinë e zhvillimit, forcimit dhe përparimit të shtetit të porsakrijuar, të njohur ndërkombëtarisht, apo nëse brenda këtyre kufijve, shteti i krijuar nuk do të mund të bëhej as i zhvilluar dhe as i qëndrueshëm politikisht. Për atë kohë vëmendja u përqendrua rreth problemit që kishte të bënte me dilemën e dytë, me të cilën lidhej drejtpërdrejtë stabiliteti i shtetit shqiptar.

Copëtimi i trojeve shqiptare në vitin 1913 ishte faktori kryesor, i cili minoi sigurinë dhe stabilitetin e shtetit shqiptar. Shqipëria, pas vendimeve të Konferencës së Londrës të vitit 1913, mbetej një shtet gjysmak, të cilit i përkisnin pjesët më të varfra të trevave shqiptare. Kufijtë e saj u përcaktuan duke mos respektuar asnjë kriter gjeografik, dhe as ekonomik. U ndanë qytetet nga krahinat përreth, duke i prishur si njësi kompakte gjeografike, ekonomike e njerëzore. “Trupi i mbetur shqiptar, me qëllimin e vetëm për të krijuar shtetin fiktiv dhe për ta bërë të pavlefshëm atë në të gjitha pikëpamjet: me një territor shumë pak prodhues dhe me një popullsi të vogël në numër”, ishte një pengesë e madhe për konsolidimin, stabilitetin dhe progresin e shpejtë të shtetit shqiptar. Këto argumente të shëndosha historike e gjeopolitike nacionalistët shqiptarë i paraqitën edhe në memorandumun e tyre pranë Konferencës së Paqes në vitin 1946¹.

Me atë memorandum vërtetohet se vështirësitë e konsolidimit të shtetit shqiptar nuk gjendeshin në karakterin dhe në nivelin e formimit të qytetërimit të kombit shqiptar, siç trumbetonte diplomacia dhe propaganda e huaj ndaj Shqipërisë. Pavarësisht se trevat shqiptare më parë ishin nën një perandori me emërtime administrative të ndryshëm (vilajete apo sanxhaqe), kanë qenë në tërësinë e vet një hapësirë shqiptare, me të njëjtin identitet gjuhësor, kulturor dhe ekonomik. Në këtë ndarje të trevave shqiptare, pas Pavarësisë, qëndrojnë rrënjët e destabilitetit të mëvonshëm të shtetit shqiptar, që mbeti një dilemë e vazhdueshme për sigurinë. Pozita mbrojtëse e kombit shqiptar si një i tërë ishte dëmtuar rëndë, sepse ishte përgjysmuar aftësia vetëmbrojtëse e shtetit shqiptar të sapokrijuar, mbasi ishte prishur ekuilibri i historisë së zhvillimit njerëzor, i ndërtuar për shekuj të tërë në Ballkan në raport me kombet e tjera. Kombit shqiptar iu imponua një ndarje e tillë. Shqiptarëve iu diktohej një mënyrë veprimi e jetese që do të ushtrohej sipas interesave të shteteve ku bënin pjesë këto treva shqiptare.

Të ndodhur para kësaj dileme të sigurisë, përvoja e dekadave më pas u tregoi shqiptarëve se, forcimi i stabilitetit të shtetit shqiptar të cunguar, nuk mund të arrihej pa luftuar njëkohësisht si *për progres, ashtu dhe për zgjidhjen e çështjes kombëtare të tyre*. Me fjalë të tjera, siguria,

¹ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej: AMPJ), viti 1946, dos. 157. Memorandum des Albanais presente le 28 juillet a la Conference de la Paix. Një kopje e memorandumit ndodhet dhe në Bibliotekën e Institutit të Evropës Juglindore në Mynih.

stabiliteti dhe progresi i shtetit shqiptar nuk mund të arrihej duke toleruar ose pranuar në heshtje copëtimin e trojeve shqiptare. Ndaj, përpjekjet për çlirim e bashkim kombëtar nuk reshtën edhe për dekada të tëra.

Rivaliteti i shteteve fqinje dhe i Fuqive të tjera të Mëdha, për sundim e influencë në Shqipëri, ka qenë faktor ndikimi negativ për sigurinë dhe stabilitetin e shtetit shqiptar, për rrjedhojë, dhe në Ballkan. Në raste të caktuara, kur në Ballkan ka pasur riorganizime politike ose territoriale, ky faktor ka shkaktuar kriza dhe anarki në Shqipëri.

Kujtojmë se, shpërthimet e trazirave apo të vatrave të krizës në Shqipëri gjatë viteve 1913-1915, në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut, gjatë lëvizjes esadiste në vitet 1920-1921, gjatë ndërhyrjes së huaj në problemet e luftës së shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore etj., nuk patën vetëm shkaqe të brendshme. Ato kanë pasur gjithmonë edhe nxitje të jashtme që, në disa raste, kanë qenë shkak kryesor, siç ishte shpërthimi i luftës civile në vitet 1943-1944. Ishte ndërhyrja e PK Jugosllave në problemet e marrëdhënieve të forcave politike shqiptare, që përfaqësoheshin nga nacionalistët e komunistët, që i çoi ata drejt konfliktit të brendshëm. Për interesat e tyre, pas luftës, ndaj Shqipërisë, nuk mund ta pranonin bashkëpunimin e të gjitha forcave politike në Shqipëri. Prandaj, përfaqësuesit e PKJ në Shqipëri ndikuan drejtpërdrejtë për të prishur Marrëveshjen historike të Mukjes dhe për shpalljen e luftës civile të PKSH kundër nacionalistëve shqiptarë. Ky "infeksion" politik pati rrjedhoja shumë të gjata për jetën politike të Shqipërisë pas Luftës II Botërore.

Duke shfrytëzuar pozitën e dobët të shtetit të cunguar shqiptar, shtetet fqinje kanë synuar të realizojnë ndaj Shqipërisë dy qëllime: 1 - T'i shkëpusin asaj territore të tjera, veç atyre që kishin marrë.

2 - Të dobësonin sa më shumë të ishte e mundur shtetin shqiptar, me qëllim që të realizonin me sukses politikën e tyre konstante të dobësimit të elementit etnik shqiptar dhe spastrimin etnik të trojeve që ata kishin aneksuar.

Pozita gjeopolitike e Shqipërisë ka qenë një faktor tjetër ndikues në dilemën e sigurisë së saj. Ndryshe nga kombet e tjerë, Shqipëria nuk ka patur asnjëherë një aleat konsekuent në Fuqitë e Mëdha, të cilin ta shfrytëzonte si mbështetje për ndërtimin e jetës shtetërore.

Në vitet 30-të Shqipëria kishte hyrë në procesin e vendosjes së stabilitetit të brendshëm. Ky stabilitet u ndërpre nga ndërhyrja e faktorit të jashtëm - pushtimit fashist italian. Fuqitë e Mëdha nuk e morën në

mbrojtje shtetin shqiptar edhe pse ai bënte pjesë në Lidhjen e Kombeve me të drejta të plota. Italia shfrytëzoi politikën e mosndërhyrjes së Fuqive të Mëdha, të cilat e trajtuan pushtimin e Shqipërisë me një indiferentizëm të çuditshëm. Ata e konsideruan këtë pushtim thjesht si një "aksion italian", i cili nuk përbënte ndonjë problem shqetësues në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ky indiferentizëm për stabilitetin e brendshëm të Shqipërisë do të shfaqej dhe në qëndrimin ndaj krizës së brendshme në fund të luftës, kur midis forcave politike shqiptare u zhvillua dhe luftë civile. Kjo luftë përbënte premisë për pasigurinë e Shqipërisë pas luftës.

Me të drejtë arsyetohej e besohej nga atdhetarët shqiptarë se, Europa do ta merrte parasysh dhe do ta mbështeste të drejtën historike të kombit shqiptar, në kompaktësinë e padiskutueshme të territoreve shqiptare. Kriteri etnik i përcaktimit të kufijve ishte parim themelor për të siguruar stabilitetin jo vetëm të Shqipërisë, por edhe të Ballkanit. Në rrethanat e grabitjes së krahinave më të pasura të Shqipërisë dhe të mungesës së një aleati të fuqishëm, para shtetit shqiptar shtrohej pyetja se “ku do t’i gjejë të hollat e nevojshme që të vetëqeveriset siç duhet, të ketë një administratë serioze dhe një ushtri për të qenë?”.²

Shpresat më të mëdha për ringjalljen e shtetit shqiptar gjatë Luftës së Parë Botërore, mbështeteshin tek Austro-Hungaria, sepse, nga opinioni i gjerë i atdhetarëve shqiptarë besohej se politikës austriake i duhej një Shqipëri e fuqishme, një kundërshtar e fortë e sllavëve. Që të ishte i tillë, shteti shqiptar duhej të përmblihte gjithë trojet etnike shqiptare³.

Dilemën e sigurisë së Shqipërisë e ka ushqyer edhe ndikimi i disa faktorëve të brendshëm.

Pas sundimit të gjatë osman, në Shqipëri kishte disa shtresa të popullsisë pa një ndërgjegje të formuar kombëtare, siç ishin turkomanët dhe grekomanët. Nëse turkomanët e kishin humbur potencën e tyre në minimin e sigurisë, si rezultat i shembjes së perandorisë osmane dhe të revolucionit qemalist, grekomanët patën për një kohë të gjatë ndikim në ngjarjet për destabilizimin e Shqipërisë.

Megjithatë, duhet thënë se efektin e ndikimit të faktorit që sapo përmendëm e kufizoi dominimi i ndërgjegjes kombëtare mbi ideologjitë dhe dallimet e tjera, duke bërë të mundur që bashkëjetesa fetare ndër shqiptarët të jetë shembullore. Përgjithësisht, shteti shqiptar i ka

² Gazeta “Dielli”, datë 12.12.1912.

³ Beqir Meta, *Federata Panshqiptare “Vatra”*, Tiranë, 2001, f. 64.

dominuar fanatizmat fetare, ndonëse në disa raste i kanë marrë atij mjaft energji.

Ngjarjet e Kongresit të Lushnjës, të Luftës së Vlorës, të përballimit të intervencionit jugosllav në Veri si dhe vendimi i Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1921, ndonëse e zvogëluan dukshëm faktorin ndërkombëtar si burim i drejtpërdrejtë për minimin e sigurisë së Shqipërisë, nuk e eliminuan ndikimin e tij në sigurinë e saj. Edhe pas kësaj periudhe, respekti i disa prej Fuqive të Mëdha për pavarësinë e Shqipërisë ishte minimal. Skepticizmi i tyre për mundësinë e mbijetesës së këtij shteti ishte i madh.

Kështu, Italia shfrytëzoi vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1921, për të “justifikuar” pushtimin e Shqipërisë, duke i bërë “të heshtin” fuqitë nënshkruese.

Foreign Ofisi (Foreign Office) britanik, duke mos marrë në konsideratë vendimet e konferencave ndërkombëtare mbi Shqipërinë, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, e konsideronte të pamundur mbijetesën e shtetit të pavarur shqiptar, sepse, sipas Foreign Ofisit, “disavantazhet e angazhimit tonë për një Shqipëri të pavarur e kalojnë shumë peshën e avantazheve”⁴, madje, diplomatët britanikë u shprehën qartë se “ne nuk do të angazhohemi ndaj rikonstruktimit të një Shqipërie të pavarur”⁵. Edhe në deklaratën e 17 dhjetorit 1942 për Shqipërinë, politika britanike u shpreh “vetëm për rimëkëmbjen e pavarësisë së Shqipërisë, por jo për integritetin e saj territorial”⁶. Dilema për sigurinë e Shqipërisë mbetej permanente dhe me të papritura.

Deklarata britanike e dhjetorit 1942, e cila vinte në diskutim kufijtë e Shqipërisë, ndikoi në gjendjen e nderë dhe të pastabilizuar të marrëdhënieve me fqinjën jugor gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Për ironi të historisë, kur forca të caktuara politike shqiptare e shikonin Bashkimin Sovjetik si “aleat të madh” në luftën kundër fashizmit dhe si mbështetje për pas luftës, Moska nuk ngurronte t’i sugjeronte Jugosllavisë gëlltitjen e viktimës së vogël të Musolinit, Shqipërisë.

Nëse pozita ndërkombëtare e Shqipërisë pas vitit 1921 ishte më e stabilizuar, dilema për sigurinë u gjallërua nga *lufta politike e brendshme*.

⁴ Foreign Office, 371/24866/7677. Telegram i P. Dixon, 18 shtator 1940.

⁵ Po aty, 371/24868. Shënim i P. Dixon, 23 nëntor 1940.

⁶ Po aty, 371/33107. Memorandum i Sekretarit të Shtetit për Punët e Jashtme dërguar Kabinetit të Luftës, 1 dhjetor 1942.

Shqipëria nuk ishte e përgatitur për këtë luftë politike. Plagët e vjetra shoqërore të trashëguara, si: përçarja dhe mungesa e lidhjeve të forta midis të gjitha krahinave; mungesa e centralizmit të lartë si kusht i domosdoshëm që karakterizon unitetin shtetëror të një vendi, mungesa e udhëheqjes e një klase të ndërgjegjshme politike etj. - të gjitha këto hynë përsëri në veprim.

Grupimet politike që zhvillonin luftën e brendshme, edhe pse shpallnin programe demokratike perëndimore, ishin ende larg partive politike, në kuptimin perëndimor të fjalës. Lufta klanore e trashëguar kësaj here (në vitet 1921-1924) ishte veshur me një vello të sipërfaqshme demokracie parlamentare. Mirëpo, demokracia parlamentare kërkonte një popull të emancipuar, me kushtet ekonomike relativisht të mira, me vullnet e aftësi për të marrë pjesë në proceset politike demokratike, parametra që në Shqipëri nuk ishin arritur. Pra, dhe një qeverisjeje të tillë (demokracisë parlamentare) në Shqipëri nuk i kishte ardhur koha.

Në përpjekjet e grupimeve politike në Shqipëri dhe në përplasjet e tyre për të ardhur në pushtet, për fat të keq, është kërkuar mbështetje politike dhe ushtarake nga të huajt. Kështu ka vepruar A. Zogu më 1924, një pjesë e opozitës antizogiste në vitet 1925-1939, një pjesë e ballistëve më 1944, komunistët në vitet 1941-1945 etj. Përvoja historike ka treguar se përplasje e grupeve opozitare dhe persekutimi i opozitës në periudha të ndryshme, ka tronditur sigurinë e vendit dhe është bërë një burim destabiliteti për vendin.

Ahmet Zogu ka meritën që kuptoi se demokracia parlamentare në Shqipëri gjatë luftës së ashpër politike të viteve 1921-1924, ishte një dështim i mjerë. Duke përfituar nga përvoja e shpartallimit të përkohshëm të opozitës, ai krijoi një regjim autokratik e të centralizuar, duke bërë kujdes për respektimin e metodave kushtetuese. Ai arriti të stabilizonte shtetin, duke i përqendruar energjitë në problemet e rënda financiare dhe ekonomike të vendit. Demokracia u kufizua dukshëm. Politika elektorale ishte më pak demokratike se ç'kishte qenë në vitet 1921-1924, por realisht ajo nuk e cenonte stabilitetin e vendit. Këtij stabiliteti i shërbeu dhe kalimi i regjimit në formën e monarkisë, e cila përcjell më mirë stabilitetin dhe vazhdimësinë e shtetit, sidomos në kushtet e Shqipërisë, që ishte cfiluar prej konflikteve të brendshme dhe smirës së huaj.

Masat që u morën për forcimin dhe funksionimin e shtetit në bazë të një legjislacioni modern perëndimor, në vitet 1925-1939, si dhe krijimi

i një mjedisi ideal për rritjen e ndërgjegjes kombëtare shqiptare me anë të arsimimit, dhe të përgatitjes së inteligjencës me botëkuptim perëndimor, bënë të mundur që aspiratat perëndimore të shqiptarëve të hynin në rrugën e realizimit. Aspirata e shqiptarëve për të ecur në rrugën e zhvillimit të përparuar modern perëndimor, nuk u zbeh edhe pas peripecive të Luftës II Botërore, ku dilema e sigurisë u shfaq në format më komplekse e trishtuese. Me besimin te demokracia perëndimore, Mbreti shqiptar ngulmoi për të bashkëpunuar me Fuqitë perëndimore antifashiste në luftën kundër nazifashizmit. Por, ai dhe mbështetësit e tij mbetën të zhgënjyer sepse politika britanike vlerësoi si aleat të vërtetë vetëm fqinjët e Shqipërisë, duke vënë në pikëpyetje integritetin territorial të saj. Megjithatë, sipas një studimi amerikan të fillimvitit 1945 “Mbi gjendjen aktuale të Shqipërisë”⁷, vlerësohej orientimi politik-shpirtëror i kombit shqiptar, si një komb me orientim të theksuar e të konsoliduar perëndimor, ku rryma proamerikane zinte peshën kryesore⁸. Njëkohësisht në studim tërhiqej vëmendja e rrezikut të lindjes së një rryme prolindore, që, ndonëse në minorancë, ishte shumë e organizuar. “Ajo rrezikonte ta shtynte Shqipërinë drejt Ruisë e Jugosllavisë, duke asgjësuar inteligjencien shqiptare, qoftë dhe me çmimin e një banjoje gjaku”⁹.

Për fat të keq, ky rrezik ndodhi si rezultat i vendosjes së diktaturës komuniste në Shqipëri, e cila me dhunë vendosi “siguri” në planin e brendshëm, por me përcaktimin politik antiperëndimor akumuloi pakënaqësi të shumta si potencial për destabilitet në fillim të viteve 90. Në dallim nga vendet e tjera komuniste, viti 1990 e gjeti Shqipërinë me një sistem politik, ekonomik e social, tipik stalinist. Kalimi në ekonominë e tregut dhe në shoqërinë civile mori trajtën e një operacioni tepër të dhimbshëm dhe eksplozues, i cili do të hidhte në erë stabilitetin e vendit. Shqiptarët e përmbysën këtë diktaturë me vokacionin te demokracia dhe kultura perëndimore sepse tek ajo kanë parë dritën nga do t’i vinte shpëtimi e përparimi.

Si përfundim, në gjysmën e parë të shekullit të kaluar, dilemat e sigurisë së shtetit shqiptar ishin shumë të thella. Fuqitë evropiane, herë në blloqe e herë në mënyrë të veçantë, ishin një kërcënim për sigurinë dhe

⁷ USNA DS 87500/539.

⁸ Beqir Meta, *Tensioni greko-shqiptar (1939-1949)*, “GEER”, Tiranë, 2002, f. 469.

⁹ *Po aty*.

stabilitetin e këtij shteti. Por, këto eksperiencia nuk lëkundën orientimin properëndimor të kombit shqiptar.

Pikërisht, në këtë kontekst është shumë e rëndësishme të analizojmë lëvizjen aktuale të politikës perëndimore dhe afrimin e Shqipërisë me NATO-n, e cila shënon pikën më të lartë të kurbës historike të evoluimit nga pasiguria e shtetit shqiptar, drejt sigurisë.